

I. Universiteti Politeknik i Tiranës shpall 3 (tre) vende pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ me kohë të plotë në pozicionet e Specialistit IT, Specialistit të Personelit dhe Arkivës, si dhe Sekretarit Mësimor në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike.

A. Kandidatët për pozicionin e Specialistit të Personelit dhe Arkivës duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë mbaruar studimet “Bachelor” dhe “Master Profesional ose Shkencave” në një nga fushat e shkencave shoqërore;
2. Të kenë eksperiencë pune mbi 3 vite në pozicione të ngjashme;
3. Të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup;
4. Të zotërojnë një gjuhë të huaj.

B. Kandidatët për pozicionin e IT, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë mbaruar studimet Bachelor dhe së paku studimet në ciklin e dytë “Master Profesional” në njërin prej fushave të Inxhinierisë Informatike, Inxhinierisë Elektronike, Inxhinierisë së Telekomunikacionit, Shkencave kompjuterike ose diploma të ngjashme
2. Të kenë përvojë pune në pozicione të ngjashme;
3. Përparësi do të përbënin kualifikimet dhe certifikatat në fushën e IT;

C. Kandidatët për pozicionin “Sekretar Mësimor”, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë mbaruar studimet “Bachelor” dhe/ose “Master Profesional” në një nga fushat e shkencave Sociale/Natyrore;
2. Të kenë eksperiencë pune në pozicione të ngjashme;
3. Të zotërojnë një gjuhë të huaj të mbrojtur dhe e vërtetuar me dëshminë /certifikatën përkatëse në një nga gjuhët: anglisht, frengjisht, spanjisht, gjermanisht ose italisht.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **02.03.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.